# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5593
E enjte, 4 tetor 2018
çmimi 0.40 €


## Bushati: Retorika e Serbisë ndaj Kosovës i përket shekullit XIX

FAQE 2





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", KADRI KASTRATI FAQE 4-5

# FSK-në nuk e bën ushtri emri, por ndryshimi i misionit



Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, beson fuqishëm se FSK-ja do të arrijë të bëhet ushtri vetëm me miratimin e tre projektligjeve të propozuara në Kuvendin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se këto projektligje kësaj force ia ndryshojnë misionin, duke i dhënë detyra ushtarake për mbrojtjen e territorit të Kosovës. Sipas Kastratit, FSK-në ushtri nuk e bën emri, por ndryshimi i misionit. Ai ka vlerësuar se pas ShBA-së, edhe aleatët e tjerë strategjikë do ta përkrahin transformimin e FSK-së. Ish-komandanti i FSK-së ka treguar se edhe aleatët strategjikë të FSK-së e kanë kuptuar se transformimi i kësaj force me ndryshime kushtetuese është i pamundur

# S'ka dorëheqje, tre ministrat e PDK-së vazhdojnë punën në Qeveri



Pavarësisht prej paralajmërimeve për dorëheqje të ministrave nga radhët e PDK-së, Abelard Tahiri, Bedri Hamza dhe Besim Beqaj nuk do të largohen nga kabineti qeveritar. Këtë e kanë konfirmuar të mërkurën vetë ministrat dhe i pari i PDK-së, Kadri Veseli. Lideri i partnerit më të madh në koalicionin qeverisës, Kadri Veseli, ka thënë se nuk mund të japin dorëheqje ministrat më të suksesshëm, të guximshëm dhe vendimmarrës. Ndërkaq, ministrat e apostrofuar kanë bërë me dije se janë duke vazhduar punën e përditshme për realizim të objektivave, të politikave dhe të planeve në kuadër të ministrive përkatëse



## Projektligjet për FSK-në bashkojnë pozitën dhe opozitën, Lista Serbe kundër

Përfaqësuesit e partive shqiptare në Komisionin Parlamentar votuan pro këtyre projektligjeve, përderisa deputeti i Listës Serbe, Zoran Mojsiloviq, ishte kundër. FAQE 9

## AKTUALE

**NË DRENICË E NË LLAPUSHË NDIHET MUNGESA E SHËNJIMIT TË PERSONALITETEVE TË RËNDËSISHME KOMBËTARE!** F. 11

Jakup KRASNIQI



**APELI E HEQ MILAIM ZEKËN NGA PARABURGIMI** F. 6

**PËR NJË MUAJ NË PEJË, 22 AKTAKUZA PËR RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE** F. 10

## EKONOMI

**PROJEKTLIGJI PËR LEHONAT PARASHEH PUSHIM EDHE PËR BABANË** F. 8

**VESELI: PO HUMBIM KOHË ME TEMA PATRIOTIKE, TË ORIENTOHEMI KAH ZHVILLIMI EKONOMIK** F. 9

## KULTURË

**'EC MA NDRYSHE': RREZIKOHEN GJURMËT E FUNDIT TË HISTORISË DHE TË TRASHËGIMISË SË PRISHTINËS** F. 3



## SPORT

**DERBI I TAKON FERONIKELIT, PRISHTINA U RIKTHEHET FITOREVE** F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi kërkon ta ndryshojë strategjinë ndaj Kosovës



BEOGRAD, 3 TETOR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, e ka mbështetur politikën e Serbisë për Kosovën me fjalët se, për Moskën "është e pranueshme vetëm ajo marrëveshje me të cilën pajtohet Beogradi". Putini dhe Vuçiqi kanë biseduar edhe për raportet në mes të Rusisë dhe Serbisë, forcimin e marrëdhënieve tregtare dhe investimet ruse në Serbi.
Sa i përket rajonit, shefi i Kremlinit tha se këtu ka shumë tema që duhet të trajtohen, ndërsa Vuçiqi foli për një situatë të komplikuar në Ballkanin Perëndimor, e shtoi se Serbia "po u nënshtrohet provokimeve, ndonëse ajo do paqe dhe stabilitet".
"Zgjidhja e çështjes së Kosovës është ende tepër larg", theksoi presidenti i Serbisë, duke shtuar se vendi i tij është i vetmi i pavarur në rajon dhe si i tillë dëshiron të mbetet.
Vuçiqi është i pakënaqur me Perëndimin, e kjo Moskës i pëlqen. Analistët serbë thonë se kreu i shtetit ka dërguar disa herë kohët e fundit mesazhe për këtë pakënaqësi. Ata mendojnë se Vuçiqi do t'i vazhdojë zemërimet e tij, sepse shumë udhëheqës perëndimorë nuk u janë përgjigjur fare thirrjeve të tij telefonike, ndaj ka vendosur që këtë çështje ta shtjellojë me Rusinë dhe Putinin. Por, politologu Boban Stojanoviq mendon se Vuçiqi po përpiqet tani ta ndërrojë strategjinë ndaj Kosovës. Ai i tha "Deutsche Welle"-s se presidenti serb fillimisht mendoi të shpallë ndonjë referendum për normalizimin e marrëdhënieve.

# Bushati: Retorika e Serbisë ndaj Kosovës i përket shekullit XIX

Në konferencën e mbajtur në Tiranë, ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati, sulmoi politikën serbe, duke thënë se në lidhje me Kosovën ka një retorikë të shekullit XIX që nuk u bënë nder diskutimeve të sotme që janë të përqendruara në procesin e pajtimit dhe normalizimit të marrëdhënieve




TIRANË, 3 TETOR - Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati, në konferencën "Serbët dhe shqiptarët", të mbajtur të mërkurën në Tiranë, sulmoi politikën serbe, duke thënë se në lidhje me Kosovën ka një "retorikë të shekullit XIX që nuk u bënë nder diskutimeve të sotme që janë të përqendruara në procesin e pajtimit dhe normalizimit të marrëdhënieve". "Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiq, ka thënë se Kosova është zemra e Serbisë dhe kosovarët janë shqiptarë që jetojnë jashtë atdheut të tyre. Kjo është retorikë e shekullit XIX dhe nuk u bënë nder diskutimeve të sotme që janë të përqendruara në procesin e pajtimit dhe normalizimit. Marrëdhënia shqiptaro-serbe ka një elefant në dhomë që është Kosova, që ka përfaqësuesit e saj që flasin në interesin e saj, por edhe qëndrimi ynë është i qartë: procesi i normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi nuk zëvendësohet nga një raport i mirë Shqipëri - Serbi, por përplotësohet", ka thënë Bushati.
Në lidhje me marrëdhëniet Shqipëri - Serbi, Bushati tha: "Dialogu duhet të jetë mbi baza të sinqerta. Kemi shumë pika të përbashkëta me Serbinë dhe ka një tendencë për t'i tejkaluar stereotipat. Marrëdhëniet me Serbinë janë në progres e sipër. Vendet tona duhet të kalojnë plagët e së kaluarës dhe ka shenja për këtë", tha ai.
Bushati tha se ekziston një tendencë dhe vullnet për t'i tejkaluar stereotipat negativë që shpeshherë shoqërojnë marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe Serbisë, apo shqiptarëve dhe serbëve në rajon dhe se "mund të jetë një marrëdhënie normale mes dy fqinjëve që zhvillohet normalisht në mënyrë progresive, që i ka ulje-ngritjet dhe ka frymën polemizuese". "Janë marrëdhënie dinamike me potencial, gjithashtu të paeksploruar mirë, siç tregojnë natyrisht edhe vitet e fundit, ku kemi një frymë dhe zhvillim pozitiv, sidomos për sa i përket zhvillimit të sektorit të turizmit, ku gjithnjë e më shume serbë po e konsiderojnë Shqipërinë si një destinacion turistik", tha ai. "Janë marrëdhënie në progres e sipër edhe për shkak të faktit se programet e mobilitetit kanë filluar dhe po zbatohen ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, duke i dhënë kësisoj frymë edhe konceptit të lidhjes që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ranë dakord në kuadër të procesit të Berlinit ku, siç dihet, dy arteriet kryesore të programeve të ndërlidhjes kanë si boshte kryesore Tiranën dhe Beogradin", tha ministri Bushati.
I pranishëm si panelist në këtë konferencë ishte edhe eurodeputeti Hannes Swoboda, i cili tha se të dyja palët duhet të marrin përgjegjësi jo vetëm për vete, por dhe për rajonin, se si njerëzit mendojnë për njëri-tjetrin dhe jetojnë pranë njëri-tjetrit jo me kokën mbrapa, por duke parë të ardhmen.

## Meta: Pakti me Greqinë të votohet kur Shqipëria ta ketë Kushtetuesen

Tiranë, 3 tetor - Presidenti Ilir Meta, në një intervistë dhënë "Zërit të Amerikës", ka komentuar zhvillimet e fundit në Shqipëri, marrëveshjen për paktin detar me Greqinë, si dhe situatën në Ballkan pas ideve për ndryshimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë.
I pyetur për marrëveshjen me Greqinë për detin, presidenti Meta tha se ishte për arritjen e një marrëveshje sipas Kushtetutës së Shqipërisë. Kreu i shtetit tha se ua ka bërë të qartë kryeministrit Edi Rama dhe ministrit Ditmir Bushati, se "pakti me Greqinë duhet të ratifikohet në Kuvend kur Shqipëria të ketë Gjykatë Kushtetuese".
Në këtë intervistë kreu i shtetit komentoi dhe debatin për rastin "Xhisiela". Ai deklaroi se kishte marrë një letër nga oficeri i policisë, Emiljano Nuhu, e cila u ishte dërguar edhe institucioneve të tjera. Meta shtoi se për akuzat e ngritura duhet të ketë një informacion më të plotë dhe më të saktë nga institucionet për të krijuar një ide të qartë të asaj që ka ndodhur. "Kam marrë një letër nga oficeri Nuhu, siç është njoftuar dhe prokuroria dhe institucionet e tjera. Nuk e besova që mund ndodhte diçka e tillë. Por, duhet të kemi një informacion më të plotë dhe më të besueshëm për këtë gjë", tha ai.
Presidenti komentoi dhe fenomenin e dhunës në familje duke theksuar se shoqëria dhe institucionet nuk duhet të tolerojnë asnjë rast dhune ndaj femrave. Presidenti deklaroi se angazhimi i tij si kryetar shteti është që për dhunën në familje të ketë respektim strikt të ligjeve dhe ndëshkim të autorëve.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# S'ka dorëheqje, tre ministrat e PDK-së vazhdojnë punën në Qeveri



Pavarësisht prej paralajmërimeve për dorëheqje të ministrave nga radhët e PDK-së, Abelard Tahiri, Bedri Hamza dhe Besim Beqaj nuk do të largohen nga kabineti qeveritar. Këtë e kanë konfirmuar të mërkurën vetë ministrat dhe i pari i PDK-së, Kadri Veseli. Lideri i partnerit më të madh në koalicionin qeverisës, Kadri Veseli, ka thënë se nuk mund të japin dorëheqje ministrat më të suksesshëm, të guximshëm dhe vendimmarrës. Ndërkaq, ministrat e apostrofuar kanë bërë me dije se janë duke vazhduar punën e përditshme për realizim të objektivave, të politikave dhe të planeve në kuadër të ministrive përkatëse

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli në takimin e përbashkët me ministrin e Financave, Bedri Hamza dhe ministrin e Inovacionit, Besim Beqaj, ka bërë me dije se asnjë ministër nga radhët e kësaj partie nuk ka dhënë dorëheqje. Ai ka thënë se nuk mund të japin dorëheqje ministrat më të suksesshëm, të guximshëm dhe vendimmarrës. "Si mund të japë dorëheqje një ministër që është i guximshëm, vendimmarrës, partner i bizneseve?! Si mund të ketë zhvillim ekonomik pa partneritet me bizneset. Në të dyja anët kam dy njerëz që udhëheqin institucionet më të pakorruptuara, Ministrinë e Financave dhe Doganën", ka thënë Veseli të mërkurën në takimin e përbashkët me ministrin Bedri Hamza, ministrin Besim Beqaj dhe me përfaqësuesit e bizneseve dhe odave ekonomike të Kosovës.

Edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se do ta vazhdojë punën si ministër i Qeverisë Haradinaj. Ai ka thënë se kryefjala e angazhimit të tij politik dhe institucional është fuqizimi i sundimit të ligjit. Sipas Tahirit, sfidat janë evidente, mirëpo me përkushtim dhe dinamikë të shtuar mund të shtohen edhe rezultatet. "Kryefjala e angazhimit tim politik dhe institucional është fuqizimi i sundimit të ligjit dhe kontributi për një shtet dhe shoqëri moderne që udhëhiqet nga parimet më të ndritura të demokracisë dhe të mundësive të trajtimit të barabartë për të gjithë. Sfidat janë evidente, mirëpo me përkushtim dhe dinamikë të shtuar do t'i shtojmë edhe rezultatet", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Lajmin për largimin e tij nga kabineti qeveritar e ka përgënjeshtruar edhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Nëpërmjet një komunikate për medie ai ka thënë se është duke vazhduar punën karshi realizimit të planit të punës me synim përkrahjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë në shërbim të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës. Beqaj ka bërë me dije se nuk ka mundur të marrë pjesë në mbledhjen e fundit të kabinetit qeveritar meqë ka qenë jashtë vendit në vizitë zyrtare. "Në lidhje me spekulimet në orët e fundit në media, sipas të cilave ministri Besim Beqaj ka dhënë dorëheqje, e informojmë opinionin publik dhe mediet, se ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, nuk ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij. Me anë të kësaj komunikate përgënjeshtrojmë shkrimet e publikuara, duke informuar se ministri Beqaj është duke vazhduar punën e përditshme për realizim të objektivave, politikave dhe planeve të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në këtë kuadër Ministri Beqaj dy ditët e fundit ka qëndruar për një vizitë jashtë vendit. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e udhëhequr nga ministri Beqaj, po e vazhdon punën me intensitet të shtuar për realizimin e planit të punës, me synim përkrahjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë në shërbim të rritjes ekonomike dhe krijimit të vendeve të punës", është thënë në komunikatën për medie të lëshuar nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

## "Ec Ma Ndryshe": Rrezikohen gjurmët e fundit të historisë dhe trashëgimisë së Prishtinës

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Organizata joqeveritare "Ec Ma Ndryshe" ka reaguar në lidhje me mundësinë e rrënimit të ish-Shtëpisë së Mallrave "Gërmia", duke vlerësuar se po rrezikohen gjurmët e fundit të historisë dhe trashëgimisë së kryeqytetit. Sipas kësaj organizate, ish-Shtëpia e Mallrave "Gërmia" është një prej ndërtesave më ikonike të modernizmit në qytetin e Prishtinës dhe pjesë e kujtesës kolektive të saj. "Sot kjo ndërtesë është në rrezik të rrënimit, nën pretekstin e akomodimit të nevojave të një grupi të komunitetit artistik për ndërtimin e sallës koncertale në Prishtinë. 'EC Ma Ndryshe' konsideron se procesi i përcaktimit të lokacionit për sallën koncertale është jotransparent për publikun dhe rrënimi evntual i ndërtesës së ish-Gërmisë për akomodimin e një funksioni të ri do t'i cenonte vlerat e trashëgimisë së qytetit të Prishtinës dhe është në kundërshtim me parimet universale të trashëgimisë për mbrojtjen e shtresimeve historike të qyteteve", është thënë në reagimin e "Ec Ma Ndryshe". Kjo organizatë ka vlerësuar se ish-Shtëpia e Mallrave "Gërmia" si për nga arkitektura, po ashtu edhe për nga momentumi shoqëror, paraqet një nga ndërtesat më të rëndësishme të Prishtinës pas Luftës së Dytë Botërore.



Flet për "Epokën e re", Kadri Kastrati

# FSK-në nuk e bën ushtri em



Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, beson fuqishëm se FSK-ja do të arrijë të bëhet ushtri vetëm me miratimin e tre projektligjeve të propozuara në Kuvendin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se këto projektligje kësaj force ia ndryshojnë misionin, duke i dhënë detyra ushtarake për mbrojtjen e territorit të Kosovës. Sipas Kastratit, FSK-në ushtri nuk e bën emri, por ndryshimi i misionit. Ai ka vlerësuar se pas ShBA-së, edhe aleatët e tjerë strategjikë do ta përkrahin transformimin e FSK-së. Ish-komandanti i FSK-së ka treguar se edhe aleatët strategjikë të FSK-së e kanë kuptuar se transformimi i kësaj force me ndryshime kushtetuese është i pamundur

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 TETOR - Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, është shprehur i bindur se FSK-ja do të arrijë të bëhet ushtri me miratimin e tri projektligjeve të propozuara në Kuvend, që do t'ia ndryshojnë misionin kësaj force. Ai ka deklaruar se FSK-në në ushtri nuk e bën emri, por ndryshimi i misionit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka treguar se ndryshimi i misionit i përcakton kësaj force detyrat ushtarake për mbrojtjen e vendit. Ai ka vlerësuar se pas ShBA-së edhe aleatët e tjerë strategjikë do ta përkrahin transformimin e FSK-së në ushtri pa ndryshime kushtetuese.

Ish-komandanti i FSK-së ka hedhur poshtë pretendimet e skeptikëve se transformimi i FSK-së në ushtri mund të bëhet vetëm me ndryshime kushtetuese. "Unë ua heq këtë skepticizëm atyre 100 për qind sepse nuk ka lidhje se çfarë emri do të ketë kjo forcë. E rëndësishme është që kësaj force t'i jepet misioni ushtarak. Po e përsëris, misioni i përcakton detyrat e forcës dhe ato detyra do të jenë mbrojtja e kufijve të Kosovës, pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe operacione humanitare të udhëhequra nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja, si dhe përkrahja e autoriteteve civile. Në bazë të këtyre detyrave dalin nevojat se cilat pajisje, cili armatim, cili transport i nevojitet kësaj force për t'i kryer këto detyra ushtarake. Se a do të quhet Forca e Sigurisë, Forcë e Armatosur apo ushtri, kjo nuk është e rëndësishme", është shprehur Kastrati. Ai ka bërë me dije se kjo mënyrë e transformimit nuk do të sjellë ndonjë pengesë as në rrugën e FSK-së drejt anëtarësimit në NATO.

**"Epoka e re":** *Z. Kastrati, pas Qeverisë, edhe Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës i ka miratuar tri projektligjet për transformimin e kësaj force?*

**Kastrati:** Personalisht e përshëndes këtë veprim të Qeverisë dhe të komisionit parlamentar. Besoj se kjo është bërë në koordinim me ShBA-në dhe partnerët e tjerë tanë strategjikë, NATO-n dhe BE-në. Edhe më herët ka pasur nisma të tilla që nuk janë realizuar. Këtë herë shpresoj të ecim përpara drejt transformimit të kësaj force në ushtri, e cila është shumë e nevojshme për Kosovën. Me këto projektligje emri FSK do të mbetet, mirëpo asaj do t'i ndërrohet misioni, duke i dhënë mision ushtarak, nga cili do të dalin detyrat ushtarake me armatime të nevojshme për ta mbrojtur territorin e Kosovës dhe për të marrë pjesë në

# ri, por ndryshimi i misionit



operacione rajonale.

**"Epoka e re":** *Besoni se është i mjaftueshëm miratimi i këtyre projektligjeve në Kuvend për ta bërë FSK-në ushtri?*

**Kastrati:** Absolutisht projektligji i ri që tashmë është në Kuvendin e Kosovës i jep kompetenca të mjaftueshme kësaj force për t'i arritur synimet e saj. Kësaj force duhet t'i ndryshohet vetëm misioni. Pastaj në bazë të misionit dalin detyrat e saj ushtarake, pajisjet, armatimi dhe të gjitha elementet e tjera që janë të nevojshme për t'u zhvilluar në një forcë ushtarake. Nuk është ndonjë problem se si do ta ketë emrin ushtria e Kosovës. Kryesorja është që misioni i kësaj force të jetë ushtarak dhe nga ai mision dalin detyrat e tjera.

**"Epoka e re":** *Edhe më herët kemi pasur iniciativa të tilla të cilat janë kundërshtuar pothuajse nga të gjithë partnerët strategjikë. Si i keni parë këto kundërshtime? Kanë qenë të drejta?*

**Kastrati:** Mendoj se qëndrimet e tyre nuk kanë qenë të drejta. Ata këto hezitime i kanë pasur për shkak se mos ky proces po sjell ndonjë pakënaqësi te komuniteti serb. Mirëpo, mendoj fuqishëm se tani edhe bashkësia ndërkombëtare në krye me ShBA-në e ka kuptuar më në fund se Lista Serbe nuk do t'i votojë kurrë ndryshimet e nevojshme kushtetuese për transformimin e kësaj force në Forca të Armatosura. Për këtë besoj se tashmë janë bindur të gjithë, dhe ne me këtë rrugë kemi mundur të ecim edhe në vitin 2014. Gjatë gjithë kësaj periudhe kemi parë deklaratat e përfaqësuesve të komunitetit serb në Kuvend se ata nuk do ta përkrahin kurrë këtë proces. Tani besoj se e ka kuptuar edhe ShBA-ja këtë dhe ka dhënë mesazhin e qartë, të cilin e solli edhe kryeministri pas kthimit nga ShBA-ja, se për këtë proces e ka marrë bekimin e saj.

**"Epoka e re":** *Pas kthimit nga Amerika, kryeministri ka sjellë vetëm bekimin e ShBA-së, por ende nuk kemi ndonjë deklarim të aleatëve të tjerë. A mjafton vetëm mbështetja amerikane në këtë proces?*

**Kastrati:** Mendoj se kjo mbështetje mjafton, sepse ShBA-ja është superfuqi, e ka ndikimin edhe autoritetin e duhur. Në këtë mënyrë, jam shumë i bindur se kryeministri dhe institucionet e tjera të Kosovës, duke përfshirë edhe ministrin e FSK-së, kanë biseduar dhe lobuar edhe tek aleatët e tjerë të Kosovës dhe të FSK-së për këtë çështje. Pastaj, ne NATO-n e kemi në Kosovë, madje brenda FSK-së, dhe është e kuptueshme që ata zyrtarë në baza javore apo ditore raportojnë te shtetet e tyre për këtë çështje. Në përgjithësi besoj se shumica e aleatëve tanë nuk do të kundërshtojnë që FSK-ja të ecë tutje drejt ngritjes së kapaciteteve ushtarake. Arsyeja është shumë e thjeshtë: këto shtete janë duke zhvilluar misionin e tyre ushtarak më të gjatë në histori të NATO-s. Dhe të gjitha këto shtete harxhojnë shumë para të taksapaguesve të tyre për ta mbajtur këtë mision në Kosovë. Në një farë mënyre edhe janë lodhur duke qëndruar në Kosovë dhe jam i bindur se e mirëpresin që Kosova të ngrehë kapacitete ushtarake, në mënyrë që edhe ata të kthehen në shtetet e tyre.

**"Epoka e re":** *Kemi edhe disa skeptikë të cilët mendojnë se pa ndryshime kushtetuese FSK-ja nuk mund të bëhet ushtri e Kosovës.*

**Kastrati:** Unë ua heq këtë skepticizëm atyre 100 për qind, sepse nuk ka lidhje se çfarë emri do ta ketë kjo forcë. E rëndësishme është që kësaj force t'i jepet misioni ushtarak. Po e përsëris, misioni i përcakton detyrat e forcës dhe ato detyra do të jenë mbrojtja e kufijve të Kosovës, pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse dhe operacione humanitare të udhëhequra nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja, si dhe përkrahja e autoriteteve civile. Në bazë të këtyre detyrave dalin nevojat se cilat pajisje, cili armatim, cili transport i nevojitet kësaj force për t'i kryer këto detyra ushtarake. Se a do të quhet Forca e Sigurisë, Forcë e Armatosur apo ushtri, kjo nuk është e rëndësishme. Qysh në vitin 2014 është dorëzuar në Qeveri pakoja se çfarë armatimi, çfarë pajisje, çfarë mjete transporti dhe të tjera elemente që i duhen kësaj force për ta kryer misionin ushtarak.

**"Epoka e re":** *Kjo mënyrë e transformimit të FSK-së a mund ta pengojë rrugëtimin e kësaj force drejt integrimit në NATO?*

**Kastrati:** Absolutisht jo. NATO-ja nuk pranon organizata për shkak të emrit, por ajo pranon organizata me mision ushtarak. Kjo mënyrë e transformimit të FSK-së nuk do të sjellë asnjë pengesë që kjo forcë të ecë drejt integrimi në NATO. Në përgjithësi kjo forcë do të trajnohet dhe shkollohet me standardet më të larta të NATO-s. Gjithashtu, do të jetë e armatosur sipas standardeve të NATO-s. Në këtë mënyrë nuk do të kemi asnjë problem të marrim pjesë në operacione paqeruajtëse apo luftarake në kuadër të NATO-s.

**"Epoka e re":** *Është thënë se brenda dhjetë vjetëve kjo forcë mund t'i arrijë kapacitetet e plota ushtarake. Besoni se buxheti i Kosovës mund ta përballojë këtë?*

**Kastrati:** Nëse i referohemi edhe deklaratës së ministrit të Financave, Bedri Hamza, për këtë çështje, ai ka treguar se transformimi i FSK-së në forcë ushtarake nuk do ta ngarkojë buxhetin e Kosovës. Plani dinamik i zhvillimit të kësaj force e ka përcaktuar se brenda një afati dhjetëvjeçar mund të arrihen ato kapacitete. Por, unë besoj se kjo mund të bëhet edhe më shpejt. Jam i bindur se edhe brenda një periudhe shtatëvjeçare kjo forcë mund t'i ngrehë kapacitetet e plota operacione. Po ashtu, jam i bindur se ekonomia e Kosovës dhe buxheti i Kosovës mund ta përballojnë këtë transformim pa asnjë problem.



## Hoxhaj: PDK-ja beson në potencialin e të rinjve

**Ferizaj, 3 tetor** - Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, së bashku me deputetin Elmi Reçica dhe kryetarin e të rinjve, Donjet Bislmi, kanë mbajtur një takim me të rinjtë e Ferizajt. Hoxhaj nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se nga të rinjtë e Ferizajt kanë dëgjuar më shumë për idetë dhe sugjerimet e tyre në ciklin e një turneu debatesh nëpër Kosovë. "PDK-ja beson në potencialin e të rinjve dhe ata presin shumë nga PDK-ja", ka thënë Hoxhaj.

## Gjilani furnizohet me 2 000 vaksina kundër gripit sezonal



**Gjilan, 3 tetor** - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Nagip Rexhepi" në Gjilan është furnizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës me një kontingjent të vaksinave kundër gripit sezonal në sasi prej 2 000 dozave. Drejtori i këtij institucioni shëndetësor, Fejzulla Berisha, ka konfirmuar se këto vaksina janë pa pagesë dhe do të vaksinohen të gjithë personat e moshuar dhe me sëmundje kronike. "Nga sot fillojmë aplikimin për të gjithë ata të cilët kanë nevojë për këtë lloj vaksine në QKMF dhe në QMF në Dardani. Sipas nevojës, vaksinat do t'i shpërndajmë edhe në qendra të tjera të mjekësisë familje dhe nëpër punkte të tjera", ka thënë ai. Sipas IKPSHK-së, për Komunën e Gjilanit janë të parapara 5 000 doza të vaksinave të kësaj natyre dhe furnizimi do të bëhet në disa faza.

## Apeli e heq Milaim Zekën nga paraburgimi



PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Gjykata e Apelit e ka lënë deputetin e Kuvendit të Kosovës, Milaim Zeka, në arrest shtëpiak, duke e rrëzuar vendimin e javës së kaluar të Gjykatës Themelore të Prishtinës. "M. Z. po dyshohet nga ana e prokurorisë për shkak të veprës penale 'Kanosje' nga neni 185, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës, vlerësoj si të arsyeshme zëvendësimin e masës së paraburgimit ndaj të dyshuarit, pasi edhe më masën e arrestit shtëpiak do të arrihej qëllimi i njëjtë i sigurimit të pranisë së tij në procedurë, ngaqë masa e arrestit shtëpiak hynë në kategorinë e masave të rënda alternative, është masë izoluese me të cilën atij do t'i pamundësohej shmangia nga procedura penale - ikja, pengimi i rrjedhës së procedurës, ndikimi në të dëmtuarit - dëshmitarët dhe, gjithashtu, do t'i pamundësohej edhe rreziku i përsëritjes së veprës penale", është thënë në komunikatën e dërguar për media.

# Ministrja Hoxha: Barazia gjinore të jetë prioritet për të gjithë sektorët

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka treguar të mërkurën se ministria që drejton ka integruar elementet e harmonisë gjinore në të gjitha dokumentet planifikuese sektoriale, duke përfshirë sektorët sikurse sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut, energjia, bujqësia, mjedisi, reforma e administratës publike, menaxhimi i financave publike si dhe konkurrueshmëria dhe inovacioni



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Me rastin e lansimit të analizës gjinore në Kosovë, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur një fjalë rasti ku ishin të pranishme përfaqësueset e rrjetit të grave të Kosovës dhe përfaqësues të Zyrës së BE-së, në krye me Apostolova, me ç'rast ka theksuar rëndësinë e përkrahjes së vazhdueshme për Kosovën nga Bashkimi Evropian.

Nëpërmjet Instrumentit të Paranëtarësimit, IPA, periudhën 2007-2013, ajo ka treguar se Kosova ka marrë vlerë mbi 600 milionë euro dhe për periudhën aktuale financiare të BE-së, 2014-2020, pritet që deri në fund të saj ta ketë shumën e njëjtë të financimit, me mundësi edhe rritjeje. "Gjatë kësaj kohe ne kemi integruar elementet e harmonisë gjinore në të gjitha dokumentet planifikuese sektoriale, duke përfshirë sektorët sikurse sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut, energjia, bujqësia, mjedisi, reforma e administratës publike, menaxhimi i financave publike si dhe konkurrueshmëria dhe inovacioni", ka theksuar Hoxha. Sipas saj, janë ndërmarrë masa që ministritë përfituese nga këto fonde ta integrojnë elementin gjinor që nga faza fillestare e planifikimit e deri në zbatimin e këtyre projekteve. "Konsiderojmë se kemi arritur që në vitet e fundit ta përmirësojmë ndjeshëm cilësinë e dokumenteve të IPA-s për sa i përket harmonizimit gjinor dhe këtë e kemi bërë pikërisht me ndihmën e Rrjetit të Grave të Kosovës. Ne besojmë se ne kemi nevojë ta vazhdojmë bashkëpunimin tonë drejt një tranzicioni që mundëson arritjen e pronësisë sonë ndaj procesit të harmonizimit gjinor në kuadër të realizimit të asistencës së BE-së për Kosovën, dhënë nëpërmjet IPA-s", është shprehur ministrja Hoxha.

Ajo ka thënë se gratë e Kosovës kanë arritur suksese të dukshme, janë avancuar në universitete, në nivelin e punësimit në biznes, kulturë, art dhe fusha të tjera. Sipas Hoxhës, gra të jashtëzakonshme kanë siguruar rrugën që zëri i tyre të dëgjohet duke shfrytëzuar talentin e tyre edhe për fuqizimin ekonomik të grave, si parakusht për zhvillimin ekonomik e social të shoqërisë. Ministrja Hoxha ka shtuar se si koordinatore kombëtare e IPA-s do t'i vazhdojë përpjekjet për arritjen e harmonizimit gjinor në kuadër të fondeve IPA.

Ajo ka treguar se është ndërtuar një model i suksesshëm i bashkëpunimit me qëllim të harmonizimit gjinor që mund të përdoret si shembull edhe për institucionet tona në kuadër të proceseve të tjera.

## Ministri Bytyqi takon rektorin Dema, flasin për ngritjen e cilësisë në arsim

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka takuar rektorin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, kryesuesen e Këshillit Drejtues të UP-së, Ardiana Bunjaku dhe përfaqësues të tjerë të KD-së dhe të Parlamentit Studentor të UP-së, të cilët i ka uruar për një fillim të mbarë e të suksesshëm të vitit të ri akademik 2018/19. "Universiteti i Prishtinës pa dyshim është kupola e arsimit të lartë në Kosovë dhe të gjithë së bashku, në bashkërenditje me Këshillin Drejtues, Parlamentin Studentor, profesorët dhe studentët, mund dhe duhet ta bëjmë më të mirën e mundshme që ky institucion i dashur për të gjithë, vërtet të shkëlqejë në çdo aspekt", ka thënë Bytyqi.

Ai ka shtuar se MAShT-i është e interesuar dhe e përkushtuar për rritje të vazhdueshme të cilësisë në këtë institucion, që Universiteti i Prishtinës të jetë shembulli i suksesit për të gjithë. "MAShT-i me politika adekuate mbështet fuqishëm Universitetin e Prishtinës në rritën dhe zhvillimin e tij akademik dhe jemi të gatshëm që kurdoherë që është nevoja ta ofrojmë mbështetjen e duhur për zgjidhjen e problemeve eventuale që shfaqen, në funksion të zhvillimit të UP-së, për realizimin e agjendave dhe ngritjen e cilësisë, si synim i përbashkët i të gjithëve. Ne jemi të gatshëm ta mbështesim edhe Parlamentin Studentor të Universitetit të Prishtinës, çdo kërkesë të tij të arsyeshme, e cila është në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim dhe në interes të studentëve tanë", ka thënë Bytyqi.



# Projektligjet për FSK-në bashkojnë pozitën e opozitën, Lista Serbe kundër

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka miratuar të mërkurën tri projektligjet për FSK-në të cilat transformojnë këtë forcë në forca të armatosura. Këto projektligje tani pritet të kalojnë në Kryesinë e Kuvendit, e cila vendos se kur do të shqyrtohen për miratim në një prej seancave të radhës. Përfaqësuesit e partive shqiptare në Komisionin Parlamentar votuan pro këtyre projektligjeve, përderisa deputeti i Listës Serbe, Zoran Mojsiloviq, ishte kundër.

Ai ka thënë se këto projektligje qartazi tregojnë transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri dhe se, përveç emrit, asgjë tjetër nuk do të jetë e njëjtë. "Kompetencat dhe përgjegjësitë që do të kishte kjo forcë e dëshmojnë këtë transformim, vetëm emri do të mbetet i njëjtë si Forca e Sigurisë së Kosovës. Unë jam i habitur sepse e di që kjo është në kundërshtim me porositë që kemi marrë nga NATO-ja gjatë vizitës sonë të përbashkët në Bruksel. Për komunitetin serb, prej të gjitha strukturave të sigurisë, vetëm KFOR-i është i pranueshëm, dhe se besimin më të madh serbët e kanë te kjo forcë", është shprehur deputeti Mojsiloviq.

Ndërkaq deputetët e pozitës dhe të opozitës në këtë Komision thanë se procedimi i këtyre projektligjeve është i një rëndësie të madhe, pasi ekziston nevoja që FSK-ja të transformohet në forcë të armatosur, përkatësisht në Ushtri të Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare.

Deputeti i PDK-së, Fatmir Xhelili, ka thënë se ky transformim do të kishte ndikim në stabilitetin rajonal, por edhe në përfshirjen e Kosovës në misione paqeruajtëse. "Këto projektligje nuk janë në dëm të askujt, por në shërbim të mbrojtjes dhe integritetit dhe pronës së gjithë qytetarëve", ka thënë Xhelili.

Deputeti i partisë më të madhe opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, ka thënë se kjo parti e përkrahë transformimin e FSK-së si dhe do të votojë për.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, mbështeti këto projektligje, mirëpo tha se gjatë dy leximeve në Kuvendin e Kosovës, nevojitet plotësimi i tyre në mënyrë që të përmirësohet roli i kësaj force për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të Kosovës.



Deputeti i AAK-së, i cili është edhe anëtar i këtij komisioni, Daut Haradinaj, ka uruar qytetarët e Kosovës për këtë votim nga ana e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai ka thënë se Kosova po shkon edhe një hap më tutje për kompletimin e saj kushtetues. "Ushtria jonë do të jetë aleate e fuqishme e NATO-s, në krye me ShBA-në. Do të garantojë paqe në rajon dhe do të jetë e gatshme për të shërbyer krahë për krahë me aleatët tanë", ka shkruar deputeti Haradinaj.

Deputetja e Partisë Socialdemokrate, Aida Dërguti, ka treguar se në emër të Partisë Socialdemokrate ka votuar për miratimin në parim të tri projektligjeve që i avancojnë kompetencat, detyrat, organizimin dhe funksionim e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Forca e Sigurisë së Kosovës, me legjislacionin e ri, do të marrë rolin e ruajtjes së integritetit territorial të vendit, qytetarëve, pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës", ka thënë deputetja Dërguti.

# Nënshkruhet marrëveshja për rritje të llogaridhënies në prokurimin publik

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me krerët e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), Ministrisë së Shëndetësisë (Msh), Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe qeverisjes së mirë në procesin e prokurimit. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishte edhe ambasadori britanik në Kosovë.




Përmes këtij memorandum, KDI-ja mori zotimin e palëve nënshkruese për bashkëpunim në projektin e monitorimit të shpenzimit të parave publike në tenderët e MI, MSh, KEK dhe AQP përmes projektit për rritje të mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies së institucioneve publike të Kosovës që përkrahet nga Ambasada Britanike.

Me këtë rast drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka theksuar se KDI-ja si degë e Transparency International ka një kohë të gjatë që është e angazhuar në luftën kundër korrupsionit dhe se ky projekt është një tentativë për ta ofruar ekspertizën e tyre për parimet e mirëqeverisjes, për parimet e llogaridhënies, transparencës në shfrytëzimin e parasë publike.

Ambasadori britanik në Prishtinë, Ruairi O'Connell, ka thënë se prokurimi publik në Kosovë po përballet me sfida të shumta dhe se shpesh ka shërbyer si burim i korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Jemi të gjithë dëshmitarë të skandaleve të njëpasnjëshme dhe akuzave të kontratave të fryra në prokurim. Kur është në pyetje një punë private, njerëzit mund të vendosin si të duan dhe t'i japin kontratat kujt të duan, por kur zyrtarët marrin vendime në emër të qytetarëve të Kosovës, ata duhet të mendojnë për interesin e qytetarëve se si i shpenzojnë fondet publike dhe jo për përfitimet e tyre personale", ka shtuar ai. Sipas O'Connellit, Kosova ka pasur iniciativa, struktura, burokraci një pas një për ta parandaluar korrupsionin dhe faktor kryesor është vullneti politik, që ka munguar dhe e ka lejuar korrupsionin.

# Kapja e shtetit të Kosovës përmes 'ekonomisë politike të zhavorrit'




Florent Spahija nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë me dije se ndërtimi i hovshëm i pasluftës në Kosovë, i pasuar me një rritje të madhe të investimeve publike në infrastrukturën rrugore gjatë dekadës së fundit, ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në zinxhirin e vlerave të sektorit të ndërtimit, duke rritur kërkesën për zhavorr-rërë ndërtimi

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të programit "Kapja e shtetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi", i cili zbatohet nga rrjeti global Transparency International, ka bërë të mërkurën publikimin e raportit "Kapja e shtetit: Ekonomia politike e zhavorrit". Në hapje të konferencës, Florent Spahija nga KDI-ja ka theksuar se projekti ka pasur si synim të vërtetojë nëse shtetet e Ballkanit Perëndimor shfaqin shenja të dukurisë së kapjes së shtetit. "Nuk ka përkufizim të qartë të kapjes së shtetit, por vetëm një seri përpjekjesh nga studiues dhe akademikë. Në njërin prej tyre, kapja e shtetit, u referohet praktikave jolegjitime (jo domosdoshmërisht kundërligjore) që minojnë vlerat thelbësore demokratike në dobi të interesave të ngushta, shpeshherë të rezervuara dhe të pushtetshme", ka thënë ai.

Ndërtimi i hovshëm i pasluftës në Kosovë, i pasuar me një rritje të madhe të investimeve publike në infrastrukturën rrugore gjatë dekadës së fundit, sipas tij, ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në zinxhirin e vlerave të sektorit të ndërtimit, duke rritur kërkesën për zhavorr-rërë ndërtimi. Sipas Spahijës, kjo ka çuar në një rritje dramatike të aktivitetit të nxjerrjes së zhavorrit nga kompanitë e ndërtimit në shtretërit e lumenjve dhe në kodrat e Kosovës e që kanë shkaktuar dëme serioze mjedisore, me efekte të valëzuara në ekonomitë lokale dhe jetesën. "Meqë aktiviteti i guroreve ka vazhduar dhe është zgjeruar, kompanitë kanë vepruar me një mosndëshkueshmëri pothuajse të plotë dhe mosrespektim të rregullave mjedisore dhe janë mundësuar ta bëjnë këtë me anë të lidhjeve të tyre politike. Këto lidhje janë manifestuar nëpërmjet ndikimit politik në emërimet kryesore në organet rregullative dhe në mungesën e fuqizimit të mekanizmave të tjerë mbikëqyrës. Edhe pse inspektorët dhe mediat kanë raportuar shkeljet, janë ngritur pak ose aspak aktakuza dhe, rrjedhimisht, është zhvilluar një klimë e mosndëshkueshmërisë. Mungesa e një përgjigjeje gjyqësore mundëson që situata aktuale të klasifikohet si kapje dhe jo thjesht korrupsion", ka potencuar Spahija.

Kurse Arben Kelmendi nga KDI-ja ka bërë prezantimin e të gjeturave dhe rekomandimeve të këtij raporti. Bazuar në të gjeturat, ai ka bërë me dije se ky raport rekomandon që të reduktohet ndikimi politik dhe të fuqizohen institucionet rregullative dhe mbikëqyrëse përgjegjëse për nxjerrjen e zhavorrit, të rritet transparenca në lidhje me financimin e fushatës së subjekteve politike, të mbështeten përpjekjet e gjyqësorit për përcjelljen e punës së inspektorëve.

Po ashtu, raporti rekomandon që të rritet përmbajtja nga sjellja e paligjshme. "Kompanitë e përfshira në praktikat e paligjshme të gurthyesve vazhdojnë të përfshihen në aktivitete të tilla edhe pasi të gjobiten, sepse përfitimet financiare mbeten shumë më të mëdha. Nevojiten përpjekje dhe dënime shtesë për t'i frenuar kompanitë nga përfshirja në këto praktika", ka shpjeguar Kelmendi.

Gjithashtu, ai ka thënë se duhet të fuqizohet shoqëria civile dhe të përmirësohen të dhënat mjedisore si dhe të shfrytëzohen zotimet karshi integrimit në BE që t'u bëhet presion elitave politike drejt reformave.

Projekti mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian dhe zbatohet nga zyrat e Transparency International në gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë) dhe Turqi.

# Projektligji për lehonat parasheh pushim edhe për babanë

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në një konferencë për media të mërkurën ka lansuar konsultimet publike për Projektligjin e Punës dhe Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindërorë të hartuar nga MPMS-ja. Me këtë rast, Reçica ka ftuar sindikatat, bizneset dhe përfaqësuesit e tyre, shoqërinë civile, ekspertë të fushave, që të kontribuojnë me komente e sugjerime të cilat do të përfshiheshin në realizimin e të drejtave për qytetarët tanë, e që synohen të përfshihen në projektligjet e lartpërmendura.




Duke folur për këto dy projektligje, Reçica ka thënë se ato janë një prej reformave kyçe që MPMS-ja ka ndërmarrë, që kanë për qëllim mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punës në marrëdhëniet kontraktuale punëdhënës-punëmarrës, trajtimin meritor të nënave lehona në Kosovë, si dhe është në funksion të zhvillimit dhe avancimit të procesit drejt fazës integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian. Nëpërmjet tyre synohet të rregullohet marrëdhënia e punës ku do të përfshihen kontratat e punës dhe format e lidhjes së kontratës, orari i punës, gjobat, pushimi i lehonisë, paga minimale, pushimi mjekësor, pushimi pa pagesë dhe elemente të tjera që përmbledhin fushën e marrëdhënies së punës. Këto dy projektligje, në të cilat janë inkorporuar direktiva dhe praktika të mira nga BE-ja, synojnë të përmirësojnë elemente të cilat kanë qenë të papërshtatshme në ligjin aktual të punës.

Sa i përket pushimit të lehonisë, Reçica ka thënë se në tre muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa do të bëhet nga punëdhënësi me 70 për qind të pagës bazë, gjashtë muajt në vijim do të paguhen nga Qeveria e Kosovës me 50 për qind të pagës mesatare në Kosovë dhe tre muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.

Në Ligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror për herë të parë do të trajtohen edhe lehonat e papunësuara të cilat do të kompensohen me një shumë të caktuar të pagës minimale për gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë.

Me këtë projektligj parashihet edhe pushimi prindëror pa pagesë në kohëzgjatje prej katër muajsh për nënën dhe babanë derisa fëmija ta mbushë moshën dyvjeçare.

# Veseli: Po humbim kohë me tema patriotike, të orientohemi kah zhvillimi ekonomik

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një takim me përfaqësuesit e bizneseve dhe të odave ekonomike të Kosovës, ka bërë thirrje të kthehet vëmendja kah ekonomia e të lihen anash debatet patriotike të çështjeve ditore. Ai ka paralajmëruar se së shpejti do të ndërmerren hapa të tjerë që kanë të bëjnë me lehtësime tatimore dhe burokratike për teknologjinë e informacionit, fermerët, shërbimet dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 TETOR - Ministri i Financave, Bedri Hamza, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri i Inovacionit, Besim Beqaj, kanë mbajtur të mërkurën takim publik me përfaqësuesit e bizneseve dhe të odave ekonomike të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, bizneset u informuan për punën dhe angazhimin e Ministrisë së Financave në lidhje me ndryshimet e politikave fiskale të cilat po ndodhin tani si dhe për iniciativat e reja në këtë fushë. Në këtë takim u dëgjuan kërkesat e bizneseve të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet në të ardhmen në politikat fiskale, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të mirë të të bërit biznes në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka apeluar që të kthehet vëmendja te ekonomia e të lihen anash debatet patriotike të çështjeve ditore. Ai ka thënë se do të vazhdohet reforma ekonomike e fiskale. "Për aq sa e kemi biznesin e fortë, ne mund ta bartim si mesazh të sovranitetit në mbarë territorin e vendit. Po humbim shumë kohë me tema patriotike. Ky është një moment që ta përçojmë një mesazh që të orientohemi kah pjesa e zhvillimit ekonomik. Sektori privat e bën zhvillimin ekonomik e jo ai publik. Do t'i vazhdojmë reforma ekonomike e fiskale", ka deklaruar Veseli. Ai ka paralajmëruar se së shpejti do të ndërmerren hapa të tjerë që kanë të bëjnë me lehtësime tatimore dhe burokratike për teknologjinë e informacionit, fermerët, shërbimet dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. "Së shpejti do të hyjnë në zbatim edhe hapa të tjerë që kanë të bëjnë me lehtësime tatimore dhe burokratike për teknologjinë e informacionit, fermerët, shërbimet dhe sektorë të tjerë të rëndësishëm për ekonominë tonë", ka thënë Veseli.

Ndërsa ministri Financave, Bedri Hamza, ka thënë se janë bërë mjaft reforma. "Kemi marrë vendim për lirimin nga dogana për lëndën e parë për prodhuesit. Ky vendim është marrë se kemi deficit tregtar dhe kjo do të bëhet që të përkrahet biznesi. Nuk ka ngarkesa të reja tatimore", është shprehur Hamza. Ai ka treguar se është duke u përgatitur Projektligji për mbledhjen e TVSh-së në brendësi të vendit. "Jemi duke punuar që të mblidhet TVSh-ja në brendësi të territorit, duke pasur ndikim të madh në ekonominë e Kosovës. Pres që këtë muaj ky Projektligj të kalojë në Kuvend dhe pas kësaj të fillojë sa më shpejt të zbatohet. Qëllimi ynë është të krijojmë lehtësira në mënyrë që të tërheqim investime", ka deklaruar Hamza. Në fund, ministri i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, Besim Beqaj, ka thënë se ekonomia e Kosovës duhet të riorientohet në ekonominë digjitale. "Sektori i teknologjisë dhe inovacionit ka bilanc pozitiv falë politikave të ndërmarra. Duhet ta bëjmë riorientimin e ekonomisë në ekonomi digjitale, sepse këtu është e ardhmja", ka thënë Beqaj.



## Formohet paneli për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të KOSTT-it

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e së mërkurës, të kryesuar nga Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit, ka formuar panelin për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it. Pas debateve të zhvilluara lidhur me këtë çështje, komisioni vendosi që në përbërje të këtij paneli të jenë: kryetarja e komisionit, Sala Berisha-Shala dhe deputetët, anëtarë të komisionit, Hykmete Bajrami dhe Adem Hoxha.

Në këtë mbledhje komisioni ka diskutuar edhe për shkeljen e dispozitave të Ligjit për komunikime elektronike nga anëtari i Bordit të ARKEP-it. Lidhur me këtë rast, komisioni, pasi shqyrtoi informatën, sipas së cilës, një anëtar i Bordit të ARKEP-it ka rënë ndesh me ligjin përkatës, vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë shkarkimin e tij në një nga seancat e radhës.



# Për një muaj në Pejë, 22 aktakuza për raste të dhunës në familje

PEJË, 3 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës ka ngritur 22 aktakuza për një muaj për rastet e dhunës në familje. "Si rezultat i koordinimit të punës së Prokurorisë Themelore të Pejës, Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave dhe Policisë se Kosovës, kemi edhe ngritje të efikasitetit në drejtim të luftimit të kësaj dukurie negative, ashtu që vetëm në muajin shtator 2018 nga kjo prokurori janë ngritur 22 aktakuza për rastet e dhunës në familje, për veprat penale si në vijim: tetëmbëdhjetë (18) për veprën penale 'Lëndim i lehtë trupor', nga neni 188 i KPRK-së, tri (3) për veprën penale 'Kanosje', nga neni 185 dhe një aktakuzë për veprën penale 'Mospërfillja e gjykatës', nga neni 401", është bërë me dije në njoftimin për media. Sa iu përket viktimave të këtyre rasteve, 21 janë të gjinisë femërore, kurse një i gjinisë mashkullore, ndërsa në cilësinë e të pandehurit që të gjithë janë nga gjinia mashkullore. Prokuroria me rastin e ngritjes së këtyre aktakuzave nga Gjykata Themelore e Pejës ka kërkuar që të pandehurit të shpallen fajtorë për veprat penale të cilat u vihen në barrë dhe të njëjtit të dënohen sipas ligjit.



# Begaj vazhdon traditën, përkrahen 153 bletarë malishevas



MITROVICË, 3 TETOR (ER) - Komuna e Malishevës, në kuadër të përkrahjes në fushën e bujqësisë, të mërkurën i ka përkrahur bletarët, me mjete konkretizuese për bletë. Numri i bletarëve të përkrahur është 153 bletarë, aq edhe sa kanë aplikuar, ndërsa janë përkrahur me mjete, varësisht nga numri i bletëve që i kanë.

Për shpërndarjen e këtyre mjeteve për bletarë kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Blegtori dhe Zhvillim Rural, Murat Hoxha, të cilët edhe i kanë uruar bletarët përfitues. "Ne po përpiqemi ta përkrahim sektorin e bujqësisë, përfshirë edhe bletarinë, edhe pse nevojat janë shumë më të mëdha se mundësitë që kemi, por brenda këtyre mundësive jemi duke bërë të pamundurën. Ju i gëzofshi këto mjete, dhe uroj që të kemi sa më shumë prodhim", ka thënë kryetari Begaj gjatë shpërndarjes së mjeteve për bletarët.

Ndërsa drejtori Hoxha ka bërë me dije se edhe kjo përkrahje për bletarët, sikur edhe përkrahja në të gjitha fushat e bujqësisë, bëhet me qëllim të përkrahjes dhe stimulimit të bujqve, fermerëve dhe bletarëve, që të merren me bujqësi, në këtë rast të merren me kultivimin dhe rritjen e bletëve, që tregu ynë të ketë vetëm prodhime vendore. "Kjo nuk është as përkrahja e parë dhe nuk do të jetë as e fundit, pasi ne në vazhdimësi do të përpiqemi t'i përkrahim bletarët dhe bujqit në përgjithësi, pasi bujqësia është prioritet", ka thënë drejtori Hoxha.



## Zyrtarët e LDK-së përkujtuan ish-kryetarin e Mitrovicës, Faruk Spahija

MITROVICË, 3 TETOR (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ismet Beqiri bashkë me kryetarin e degës së kësaj partie në Mitrovicë, Safet Kemberi, të mërkurën kanë bërë homazhe në 13-vjetorin e vdekjes së ish-kryetarit të Komunës së Mitrovicës dhe anëtarit të Kryesisë së LDK-së, Faruk Spahija. Po ashtu, ata i bënë vizitë familjes së tij. "Ishte një intelektual, njeri i urtë, i afërt, i vendosur, pragmatik, bashkëpunëtor i presidentit historik dr. Ibrahim Rugova. Ishte nder dhe kënaqësi të punojmë bashkë në kohë jo të lehta, në Kosovën e pasluftës", ka thënë Beqiri.

# Diskutohet për funksionalizimin e parkut të biznesit në Marinë

SKENDERAJ, 3 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, edhe drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Mehmet Berisha, kanë pritur të mërkurën në takim drejtoreshën e Agjencisë Zhvillimore Rajonale Veri, Rreze Duli, si dhe Kreshnik Thaqin e Armend Vehapin nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, KIESA.

Gjatë takimit është diskutuar për hapat që duhet t'i ndërmarrë Komuna e Skenderajt sa i përket funksionalizimit të Parkut të Biznesit në Marinë.

Kryetari Jashari ka marrë premtime nga drejtoresha Duli dhe, po ashtu, edhe nga zyrtarët e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, se do t'i ofrojnë përkrahje dhe ndihmë në proceset e krijimit të parkut.



Kryetari Jashari i ka falënderuar zyrtarët për gatishmërinë e treguar rreth përkrahjes dhe ndihmës së nevojshme në mënyrë që Parku i Biznesit në Marinë të jetë model në Kosovë.

## Gati në përfundim asfaltimi i rrugës Beleg - Llukë

DEÇAN, 3 TETOR - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije të mërkurën se asfaltimi i rrugës e cila lidh fshatrat Beleg dhe Llukë e Epërme është në përfundim. "Falënderim i veçantë për Ministrinë e Infrastrukturës për bashkëpunim! Angazhimi ynë është çdo ditë dhe do të jemi të pandalshëm për zhvillimin dhe ndërtimin e komunës sonë!", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Në Drenicë e në Llapushë ndihet mungesa e shënjimit të personaliteteve të rëndësishme kombëtare!



Jakup KRASNIQI

Pas çlirimit në Kosovë është mirë që po ndërtohen shtatore për të rënit në luftën e fundit, por historia jonë nuk fillon në vitet '90 e as në fund të shekullit XX. Pra, historia nuk fillon e as mbaron me një a dy gjenerata, qofshin edhe gjenerata luftëtarësh. Populli ynë ka shumë personalitete në kohë të ndryshme, e sidomos në shekullin XIX e XX që në forma të ndryshme kanë mbajtur të gjallë frymën e atdhedashurisë e të liridashësisë, të edukimit e të drejtësisë me të cilat kanë mbajtur gjallë frymën e kombëtarisë, të drejtësisë e të moralit, të kulturës e të edukimit të njerëzishëm të brezave.

Kësaj radhe do të shkruaj për disa personalitete kombëtare që lidhen shumë ngushtë me trevën e Drenicës dhe atë të Llapushës. Nuk kam asnjë mëdyshje, Drenicës i mungojnë monumentet e tri personaliteteve të veçanta historike dhe emblematike të kohëve të ndryshme. Sipas rendit, Drenica duhet ta ngrehë përmendore për mendjen më të urtë, urtësia e të cilit është përsëritur gojarisht ndër breza. Fjalën e kam për mendimtarin e urtë, Xhemajl Abrinë ose, siç i thoshin ndryshe, Xhemajl Aga. Xhemajl Abria me lakminë njerëzore (smirën) nuk dëshironte të shkonte askund së bashku, në asnjë kuvend burrash a mexhlis, se ajo e pengonte të ishte njeriu i duhur për njerëzit e kombin e tij, për drejtësinë që aq shumë kishte nevojë kombi ynë. Drenicës, gjithashtu, i mungon shumë monumenti për luftëtarin e veçantë e të vendosur të Luftës së Drenicës, Shaban Palluzhën, trimin shtatëdhjetëvjeçar i cili në një kohë tepër të vështirë, atdheut i doli zot, duke i treguar armikut se vendi ynë kishte zot - shqiptarët. I treti është mësuesi e revolucionari Fazli Greiçefci, i cili, duke luftuar për flamurin kuq e zi, u bë edhe vetë flamurtar i lirisë! Flamurtar i Lëvizjes Revolucionare për çlirim e bashkim kombëtar. Secili nga këto personalitete janë kryeemblema të kohëve të tyre. Këta ishin emra të përveçëm, emra që flasin shumë për dje, për sot e për nesër.

Si Drenicës, ashtu edhe Llapushës, i mungojnë tri monumente të mëdha, mbase edhe më shumë. Llapushës i mungon monumenti i vizionarit e parashikuesit më të madh të kohës, i mungon monumenti i Tahir Berishës. I familjes që dha shumë për lirinë dhe atdheun tonë. I mungon dhe i mungon shumë, monumenti i plakut të drejtësisë kanunore, Ramadan Shabanit, i personalitetit më të madh të drejtësisë popullore (kanunore) edhe në rrafshin kombëtar. Edhe kjo familje, drejtësisë kanunore i dha shumë breza pleqnarësh për më shumë se një shekull. Drejtësia e tyre nuk është kontestuar as edhe një herë. Dhe personaliteti i tretë pa dyshim se është rapsodi i folklorit shqiptar, gjithashtu i njohur edhe në rrafsh kombëtar për zërin e tij karakteristik, Salih Bajrami - Krasniqi nga Drenoci i Vllehve. Do të ishte në nderin e kohës sonë, të mendonim seriozisht, për përjetësimin e këtyre gjashtë personaliteteve në monumente kulture e historie kombëtare, pasi secili në mënyrën e vet kontribuuan shumë për brumosjen e atdhedashurisë e urtësisë kombëtare ndër breza.

Këto personalitete i profilizova si të nivelit lokal por, në fakt, janë personalitete të mëdha edhe në rrafshin kombëtar dhe meritojnë përjetësimin e emrit të tyre në monumente të ndryshme kulturore a medalje të ndryshme vlerësimi e përkujtimi për gjenerata të shumta. Shkrova për këto personalitete, ndonëse jam shumë i bindur se harresa jonë i ka lënë nën hije edhe shumë personalitete të tjera anekënd Kosovës e Shqipërisë. Të shpresojmë se do të vijë një gjeneratë që mendon e rezonon përtej interesave të ngushta familjare, gjenerate a provinciale dhe nxjerr në peshore të gjithë mendjet e urta të kombit, mendje që kontribuuan në shumë fusha të jetës.

Drenasi dhe Malisheva do të merrnin pamje hijeshie e krenarie me personalitetet e përmendura! Pa dyshim që kjo që thashë nuk vlen vetëm për këto komuna, por për të gjithë hapësirën tonë kombëtare. Madje këtë po e bëj për të nxitur një diskutim dinamik në nivel vendi, se historinë e lavdisë nuk e përbën vetëm një brez, qoftë ai edhe brezi i çlirimit të Kosovës, me qëllim që t'i qesim në dritë të gjitha personalitetet e kombit që i ka mbuluar pluhuri i harresës dhe ndaj të cilëve u është bërë një padrejtësi historike!

I përjetshëm qoftë kujtimi për të gjithë personalitetet e përmasave kombëtare!

# Matoshi pret në takim përfaqësuesit e CEB-it, në fokus banimi social në Kosovë

PRISHTINË, 3 TETOR (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, të mërkurën ka pritur në takim përfaqësuesit e CEB - Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (BZHKE), drejtoreshën e Departamentit të Këshillimit Teknik, Monica Brezzi, Samir Kulenovic, këshilltarin teknik për banim dhe Valeriu Cosuleanu, zyrtarin përgjegjës për Kosovë, me ç'rast kanë diskutuar për "Programin për banim social në Kosovë".



Ministri Matoshi gjatë këtij takimi ka thënë se MMPH-ja është e gatshme ta mbështesë projektin për banim social në Kosovë. "Jemi këtu për të siguruar që ky projekt që dy vjet radhazi është vlerësuar me pikë andaj për ne si projekt është i rëndësishëm për ta shtyrë tutje. Jam këtu për ta kryer pjesën e punës që më takon mua si minister, që ta mbështes këtë projekt dhe ta përfundojmë pjesën tonë që na takon si MMPH", ka thënë Matoshi.

Ndërsa drejtoresha e Departamentit të Këshillimit Teknik, Monica Brezzi, ka thënë se ky projekt do të ketë vlerësime të ndryshme dhe aktualisht, sipas saj, është në fazën e vlerësimit teknik. "Vlerësimi i projektit ka aspekte të ndryshme, njëri aspekt është teknik që po fillojmë sot, që ta shohim dizajnin e projektit, ndikimet e mundshme, përzgjedhjen e përfituesve. Pastaj ka edhe aspekte të tjera, pra do të ketë edhe çështje që do të lidhen me aspektin financiar", ka thënë Brezzi.

Ekipi vlerësues teknik i CEB-it do të qëndrojë tri ditë në Kosovë, ku do të ketë disa takime me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, me të cilët do të diskutohet mbi përmbajtjen, modalitetet e mundshme financiare dhe partneritetet, studimin e parafizibilitetit për vlerësimin e nevojave për banim social në nivel vendi, mundësinë e realizimit të një pilotprojekti për banim social si dhe për sfidat e përgjithshme të sektorit të banimit në Kosovë.

## NATO i kërkon shpjegime Rusisë për sistemin raketor

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, kërkoi të mërkurën nga Moska që të dëshmojë se ajo është duke vepruar në përputhje me një marrëveshje për reduktimin e armëve bërthamore, për shkak të shqetësimeve që ka shkaktuar një sistem i ri raketor rus.
Uashingtoni është ankuar për gati dy vjet se sistemi për hedhjen e raketave nga toka, i zhvilluar nga Rusia, shkel Traktatin e Forcave Bërthamore me Rreze të Ndërmjetme, të vitit 1987.
Të martën, ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në NATO, Kay Bailey Hutchison, tha se nëse është e nevojshme, SHBA do të shqyrtojë shkatërrimin e sistemit rus 9M729.
Stoltenberg tha se marrëveshja e nënshkruar nga presidenti i atëhershëm amerikan, Ronald Reagan, dhe udhëheqësi i atëhershëm sovjetik, Mikhail Gorbachev, mbetet "gurthemeli i sigurisë evropiane".
"Jemi shumë seriozë në lidhje me shqetësimet tona dhe shumë seriozë kur i bëjmë thirrje Rusisë që të veprojë në përputhje me traktatin në një mënyrë transparente dhe të verifikueshme", tha Stoltenberg, duke shtuar se Moska për kohë të gjatë e ka mohuar edhe ekzistencën e sistemit raketor.
"Tani që e ka pranuar se ekziston, i bëjmë thirrje që t'iu përgjigjet pyetjeve tona", tha Stoltenberg.


Rusia mohon se po shkel traktatin për armët bërthamore.

# Sanksionet ndaj Iranit: Gjykata vendos kundër SHBA-së

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka urdhëruar Shtetet e Bashkuara që t'i lehtësojnë sanksionet e rivendosura kundër Iranit, pas tërheqjes nga marrëveshja bërthamore.
Gjykata tha se eksportet e mallrave "humanitare", siç janë ushqimet dhe ilaçet, duhet të lejohen.
Gjykata me seli në Hagë vendos për mosmarrëveshjet ndërmjet shteteve anëtare të OKB-së, por SHBA-të thonë se gjykata nuk ka juridiksion mbi rastin që, sipas saj, ka të bëjë me sigurinë e saj kombëtare.
Vendimet e saj janë të detyrueshme dhe nuk mund të apelohen, por gjykata nuk ka mekanizma për t'i imponuar ato.
Duke shpallur vendimin, gjykatësi Abdulqawi Yusuf tha se "gjykata konsideron se SHBA-ja duhet të heqë, me mjetet që ajo i zgjedh, çdo pengesë në territorin e Iranit për eksportin e lirë të mallrave të kërkuara për nevoja humanitare".
Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, e tërhoqi në muajin maj vendin e tij nga marrëveshja bërthamore midis Iranit dhe gjashtë fuqive botërore.
Me këtë marrëveshje, Irani e kufizoi aktivitetin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. SHBA, pas daljes nga marrëveshja, i riktheu sanksionet.


Shutterstock

# SHBA tërhiqet nga Traktati i Miqësisë me Iranin i vitit 1955

Shtetet e Bashkuara thanë se anulojnë një traktat të miqësisë me Iranin, disa dekada të vjetër, pasi ai u përmend në një vendim të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë kundër politikës së sanksioneve të Uashingtonit.
"Njoftoj se SHBA i jep fund Traktatit të Miqësisë me Iranin, të vitit 1955. Ky është një vendim që, në fakt, është vonuar 39 vjet", tha sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, duke iu referuar vitit të Revolucionit Islamik, më 1979.
Të mërkurën, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e urdhëroi SHBA-në t'i lehtësojë sanksionet e rivendosura kundër Iranit, pas tërheqjes nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 midis Teheranit dhe gjashtë fuqive botërore.
Gjykata tha se eksportet e mallrave "humanitare", siç janë ushqimet dhe ilaçet, duhet të lejohen.
Gjykata tha se sanksionet e SHBA-së për mallrat e tilla shkelin Traktatin e Miqësisë, Marrëdhëniet Ekonomike dhe të Drejtat Konsullore midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara.
Pompeo tha se Shtetet e Bashkuara janë "të zhgënjyera" që Gjykata e Hagës "nuk arriti të kuptojë se nuk ka juridiksion të nxjerrë ndonjë urdhër që ka të bëjë me masat e sanksionimit nga Shtetet e Bashkuara", të cilat "mbrojnë interesat e tyre thelbësore të sigurisë".
Traktati i vitit 1955 bën thirrje për "marrëdhënie miqësore" midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara, inkurajon tregti dhe investime të ndërsjella, rregullon marrëdhëniet diplomatike dhe ia jep juridiksionin Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi mosmarrëveshjet.
Ai është nënshkruar në kohën e marrëdhënieve të ngushta midis Uashingtonit dhe Teheranit, shumë kohë para se Revolucioni Islamik i vitit 1979 të sillte dekadat e armiqësisë mes tyre.


Cliff Owen (AP)

## Macron detyrohet të pranojë dorëheqjen e ministrit të Brendshëm

Presidenti francez Emmanuel Macron është detyruar të pranojë dorëheqjen e ministrit të tij të Brendshëm, Gerard Collomb. 71-vjeçari Collomb paralajmëroi se pas zgjedhjeve për Parlamentin Europian do të tërhiqet nga posti ministror dhe se në vitin 2020 do të kandidojë për kryebashkiak të Lionit.
Të hënën Macron refuzoi dorëheqjen e 71-vjeçarit, por pa sukses. Ky i fundit paraqiti sërish dorëheqjen dhe presidenti u detyrua ta pranojë atë.
Dorëheqja e Collomb-it erdhi vetëm disa javë pas dorëheqjeve të dy personazheve të njohur të qeverisë së Macron.



# Helena Kadare, në një rrëfim për letërsinë në Prishtinë



Për herë të parë Helena Kadare do të jetë në një rrëfim për letërsinë dhe jetën përkah shkrimtarit të madh Ismail Kadare për lexuesin e Kosovës. Më 7 tetor ora 20.00 shkrimtarja do të jetë përballë dy gazetareve Beti Njuma e Alda Bardhyli, në kafenenë Sonder, për një rrëfim të rrallë mbi udhëtimin e pazakontë të një gruaje në letërsi.

Në historinë e letërsisë shqipe Helena Kadare hyn tek femrat e para që botuan në një letërsi të dominuar nga burrat që në vitin 1970-të me romanin "Një lindje e vështirë". Libri u prit mirë nga kritika. Më pas ajo rikthehet për lexuesin në fillim të viteve 90-të me romanin "Një grua nga Tirana", "Bashkëshortët" në vitin 2002. Me një stil të veçantë rrëfimet e Helenës janë përshkruar nga një ndjeshmëri i hollë.

Ajo ka një kontribut e në fushën e përkthimeve. Vitet e fundit ajo botoi librin autobiografik "Kohë e pamjaftueshme" ku tregon jetën e saj përkrah shkrimtarit Ismail Kadare. Udhëtimi i saj me "Letërsia dhe qyteti" drejt Prishtinës është një ngjarje për jetën kulturore, pasi sipas dy gazetareve nuk do të jetë thjesht një rrëfim por dhe një reflektim mbi mënyrën sesi kulturat sot ndërveprojnë me njëra tjetrën, dhe rolit të letërsisë sot në zhvillimet social-politike.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, Helena do të ketë dhe një takim me student të Universitetit të Filozofisë. *(gazeta-Shqip.com)*




# Si u realizua fjalori enciklopedik i Kosovës



**Mehmet KRAJA**

Të gjithë në njëfarë mënyre kemi qenë skeptikë se do të realizohet ky projekt. Nuk kemi dyshuar në përkushtimin tonë, por kemi qenë të vetëdijshëm për vështirësitë, me të cilat do të ballafaqohemi. Ka qenë një maratonë, në të cilën, natyrisht, jo të gjithë kanë pasur të njëjtën kurajë dhe qëndrueshmëri.

Megjithatë, pavarësisht nga abstenimet e ndonjë rasti, pesë vjet me radhë kemi bashkëpunuar si kurrë më parë dhe për këtë u jam mirënjohës të gjithëve, në rend të parë anëtarëve të Redaksisë Qendrore, të cilët më kanë mbështetur në çdo rast, pastaj të 24 redaktorëve të fushave, anëtarëve të redaksive të fushave dhe, natyrisht, të gjithë 506 autorëve të teksteve.

Puna rreth Fjalorit ka kaluar nëpër faza të ndryshme, duke filluar nga identifikimi i fushave, i lëndës që duhej përfshirë, pastaj i përzgjedhjes dhe klasifikimit të kësaj lënde, vjelja e të dhënave dhe natyrisht përpjekja që për herë të parë të krijojmë një standard i prezantimit, respektivisht i shkrimit enciklopedik. Të gjithëve na ka munguar përvoja dhe këtë punë e kemi bërë duke mësuar së bashku.

Krahas përdorimit të gjerë që mund të ketë Fjalori, identifikimi i lëndës enciklopedike dhe krijimi i një baze të të dhënave duhet të jetë arritja më e rëndësishme e këtij botimi. Pas botimit, natyrisht, vjen faza e shqyrtimit publik, e vërejtjeve dhe kritikave, të cilat duhet të merren para sysh, në mënyrë që një botim i ardhshëm të jetë më i plotë dhe më me pak gabime. Në përfshirjen e lëndës enciklopedike dhe në prezantimin e saj, përveç kriterit të gjithëpërfshirës, është ndjekur edhe parimi i qasjes pozitive ndaj subjekteve të zërave enciklopedikë.

Dhe, mbi të gjitha neutraliteti politik, i cili ka qenë domosdoshëm në këtë rast. Sikundër mund ta vëreni, Kosova në këtë fjalor paraqitet si entitet i mëvetësishëm dhe i tërësishëm politik, historik, ekonomik, arsimor dhe kulturor, duke u bërë kështu një kundërvënie e fuqishme ndaj tendencave dezitegruese, të cilat kanë filluar të shfaqen së fundi dhe që kanë krijuar hapësirë më të madhe se kurrë.

Botimi i këtij Fjalori ka dëshmuar se ne kemi potencial solid për projekte të kësaj natyre, që nuk e kishim më herët dhe nuk e kishim me një përqendrim të këtillë. Studiues, profesorë universiteti, shkrimtarë, publicistë dhe njerëz të dijes, të mbledhur kështu së bashku, ndërsa kanë shkruar për gjeografinë e Kosovës, për historinë, për arsimin, artin dhe letërsinë, për informimin, për fusha të ndryshme të shkencës, pra, të mbledhur së bashku përbëjnë një zë të fuqishëm për Kosovën integrale, të qëndrueshme kundrejt ideve arriviste.

*(Marrë nga gazeta-Shqip.com)*

E rrallë

# I gjithë fshati kthehet në hotel



Një fshat i quajtur Corippo, në kantonin italian të Zvicrës jugore, dikur kishte një komunitet fermerësh me 300 banorë, sot Corippo ka mbetur me vetëm 12 banorë, 11 prej të cilëve janë mbi 65 vjeç. Të vetmet veprimtari ekonomike janë një bujtinë dhe një restorant i vjetruar. Një fondacion vendës, "Corippo 1975", ka gjetur një ide për ta shpëtuar fshatin. Ata duan ta bëjnë hotelin e parë në Zvicër me dhoma të shpërndara.

FOTO E DITES



Dy dhelpra të kuqe të Arabisë janë të zbukuruara në sfondin e dritave të qytetit. / nationalgeographic/

E jashtëzakonshme

# Tajlandë, plazhi i famshëm "Maya Bay" do të qëndrojë i mbyllur pa afat



Turistët, që shpresojnë ta vizitojnë gjirin e famshëm Maya në Tajlandë, do të duhet të presin gjatë për të shkelur në brigjet e tij të bardha. Destinacioni i famshëm duhej të rihapej këtë muaj, pas një ndalimi të përkohshëm të turistëve. Por, zyrtarët tajlandezë bënë të ditur se gjiri do të mbetej i mbyllur pa afat.

## BARSOLETA E DITËS



**Pse qesh biondina kur e sheh vetëtimën?**
**Mendon se po e fotografon dikush.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

## "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky







**Në ora 18:00**

## "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

## "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Dita e sotme do të jetë suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat. Edhe pse të tjerët ju paragjykojnë pa të drejtë ju nuk do të mërziteni fare.



**DEMI**
Do të keni një udhëtim pune që në nisje do të mbartë shumë stres, por kur të përfundojë ju do të jeni fitimtar dhe mjaft të kënaqur.



**BINJAKËT**
Sot do të keni mjaft afrimitet me parterin, gjë që ju kishte munguar kohët e fundit. Atmosfera romantike do të mbizotërojë përgjatë gjithë ditës.



**GAFORRJA**
Për mirëqenien dhe lumturinë brenda mureve të shtëpisë do të jeni gati të bëni gjithçka. Një person afër jush do t'ju japë një këshillë të vlefshme.



**LUANI**
Jeni mjaft diplomat sot, megjithëse keni ndjenja të thella karshi një personi që do të arrini të mbani nën kontroll çdo sjellje tuajën.



**VIRGJËRESHA**
Në familje do të keni mjaft gjëra për të thënë sa i përket një vendimi që është marrë pa praninë tuaj. Mundohuni të arrini në një zgjidhje.



**PESHORJA**
Komunikimi është arma juaj fituese në çdo moment. Do të arrini të gjeni mënyra alternative për t'i zgjidhur ngërçet e krijuara në punë.



**AKREPI**
Përqendrohuni tek faktet sot pa u marrë me fjalë të kota që mund t`ju shpërqendrojnë nga objektivi juaj final.



**SHIGJETARI**
Sot ju mungon entuziazmi i zakonshëm për t'i bërë gjërat. Do të shikoni që nuk mund të shkoni shumë larg pa këtë detaj.



**BRICJAPI**
Me kolegët po kaloni kohë shumë të mira falë një bashkëpunimi që sapo keni nisur. Në shoqëri të tyre do të mësoni shumë gjëra.



**UJORI**
Sot keni nostalgji për të kaluarën dhe për tradicionalen. Kjo kohë ju sjell me pranë kujtimeve të fëmijërisë që këto ditë po ju shoqërojnë.



**PESHQIT**
Jeta ka ende shumë gjëra për t'ju ofruar dhe sot do t'ju mbushet mendja për këtë gjë. Do të gjeni arsye të largoheni për pak ditë.

# Kanye West, Justin Timberlake dhe Childish Gambino në Coachella



Coachella është ende gjashtë muaj larg, por tashmë po dihen performuesit kryesorë. Burimet kanë treguar për mediat amerikane se lista e artistëve performues do të konsistojë nga Childish Gambino, Justin Timberlake dhe Kanye West. Zyrtarisht lista e artistëve performues nuk do të bëhet me dije deri në janar. Festivali Coachella mbahet nga 12-14 prill dhe 19-21 prill.

# Aktorja e njohur kineze gjobitet për evazion fiskal



Aktorja kineze Fan Bingbing është gjobitur me një shumë të majme për shkak se ka kryer evazion fiskal. Lajmi vjen tre muaj pasi ylli aziatik i filmave nuk ishte parë më në publik. Fan, e cila është një nga aktoret më të paguara në Kinë, do t'i shpëtojë burgut nëse gjoba paguhet në kohën e duhur. Mendohet se aktorja e famshme kishte një kontratë ku shkruhej fitimi i saj i vërtetë dhe një tjetër që u paraqitej autoriteteve, me një shifër shumë më të ulët.



# Kim Kardashiani është një prej emrave "më të rrezikshëm" për të kërkuar në internet

Me 118 milionë ndjekës në "Instagram", 58 milionë ndjekës në "Twitter" dhe të hyra neto prej 270 milionë funtesh, Kim Kardashian West është një nga individët më të njohur në botë. Ndërsa shumë njerëz në botë mund të bëjnë kërkime në "Google" për jetën e saj ose familjes Kardashian në përgjithësi, mund të vihen në rrezik nga josiguria kibernetike, shkruan "The Independent".

# Nick Jonas dhe Priyanka Chopra janë në Indi për një festë



Nick Jonas dhe Priyanka Chopra ishin të rrethuar nga sigurimi derisa ishin për një drekë në një restorant në Jodhpur, India. Këngëtari 25-vjeçar u mundua të mbante një profil të ulët me një palë syze dhe një kapelë derisa aktorja 36-vjeçare dukej mrekullueshëm në një bluzë të bardhë të kombinuar me një fund dhe syze. Çifti i fejuar aktualisht gjendet në Indi për ta festuar ditëlindjen e një miku të ngushtë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| STANDARD LIEGE - AKHISAR | 4+ | |
| JABLONEC 97 - DYNAMO KIEV | GG | |
| KRASNODAR - SEVILLA | 2 | |

# Derbi i takon Feronikelit, Prishtina u rikthehet fitoreve



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 TETOR - Janë zhvilluar edhe katër ndeshje në xhiron e tetë në IPKO Superligën e Kosovës në Futboll, kurse derbin e kësaj xhiroje e ka fituar skuadra e Feronikelit në përballje me Llapin në "Zahir Pajaziti". Fitoreve i është rikthyer edhe skuadra e Prishtinës që në Prizren e ka mposhtur Lirinë. Drita vazhdon formën e dobët, duke mos arritur me shumë se një pikë nga përballja me Trepçën '89, kurse baras përfundoi edhe ndeshja në mes të KEK-ut dhe Ballkanit. Sot (e enjte) zhvillohet ndeshja e fundit e kësaj xhiroje. Në kryeqytet takohen Flamurtari dhe Gjilani.

### Llapi - Feronikeli 0-1

Skuadra e Feronikelit e ka fituar ndeshjen derbi ndaj Llapit me rezultat 0-1. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" i ka takuar Javës së Tetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Mysafirët nga Drenasi luajtën pa një lojtar nga minuta e 43-të, pasi Kastriot Rexha qëllimisht e goditi me top Behar Maliqin dhe gjyqtari kryesor e përjashtoi me karton të kuq. Pavarësisht prej epërsisë numerike, Llapi nuk arriti të shënojë në portën e skuadrës mysafire, kurse në anën tjetër "Nikli" shënoi golin e fitores në minutën e 73-të nëpërmjet Astrit Fazliut. Pas kësaj ndeshje Feronikeli e përforcon pozitën e parë me 20 pikë, kurse përkohësisht mbetet e dyta me 16 pikë.

### Liria - Prishtina 0-1

Fitores të mërkurën i është gëzuar edhe skuadra e Prishtinës, e cila, pas barazimit ndaj Flamurtarit, në javën e kaluar arriti ta mposhtë Lirinë në Prizren (0-1). Rastet ishin të shumta në pjesën e parë, por gola nuk pati. Në pjesën e dytë skuadra mysafire ishte më kërkuese dhe e arriti golin e epërsisë dhe të fitores në minutën e 64-t. Autor i këtij goli ishte Basit Khalid. Liria, pavarësisht prej përpjekjeve të shumta, nuk arriti ta barazojë rezultatin. Në xhiron e radhës Prishtina në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret Llapin, kurse Liria i shkon Gjilanit.

### Drita - Trepça '89 1-1

Kampionia aktuale në elitën e futbollit të Kosovës, Drita, vazhdon t'i zhgënjejë tifozët. Kjo skuadër pas humbjes në derbin ndaj Gjilanit të mërkurën nuk arriti më shumë se një barazim nga përballja me Trepçën '89 (1-1). Vendësit shënuan të parët në minutën e 18 nëpërmjet lojtarit më të mirë Xhevdet Shabani, kurse skuadra nga Mitrovica nuk u dorëzua dhe në pjesën e dytë e arriti barazimin me golin e shënuar nga Marigen Shosha (66).

### KEK-u - Ballkani 2-2

Pikën e parë në këtë edicion garash e arriti skuadra e KEK-ut, e cila e ndali në barazim 2-2, skuadrën e Ballkanit nga Theranda. Atdhe Grajçevci e solli vetëm pas dy minutave lojë në epërsi skuadrën e KEK-ut, kurse dymbëdhjetë minuta më vonë Jetmir Topalli e barazoi rezultatin në 1-1. Në pjesën e dytë Treviol Stullqakun shënoi për vendësit dhe Durim Gashi për mysafirët, kurse rezultati final i ndeshjes ishte 2-2. KEK-un në xhiron e nëntë e pret punë e vështirë, pasi luan ndaj Feronikelit në Drenas, kurse Ballkani e pret skuadrën e Ferizajt.

### IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Llapi - Feronikeli | 0-1 |
| Liria - Prishtina | 0-1 |
| Drita - Trepça '89 | 1-1 |
| KEK-u - Ballkani | 2-2 |
| Ferizaj - Drenica | 2-0 |
| Të enjten takohen: | |
| Flamurtari - Gjilani | |

Tabela

| | | |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 8 | 20 pikë |
| 2. Llapi | 8 | 16 |
| 3. Prishtina | 8 | 15 |
| 4. Flamurtari | 7 | 14 |
| 5. Gjilani | 7 | 13 |
| 6. Drenica | 8 | 12 |
| 7. Trepça '89 | 8 | 10 |
| 8. Ballkani | 8 | 9 |
| 9. Liria | 8 | 6 |
| 10. Drita | 8 | 7 |
| 11. Ferizaj | 8 | 7 |
| 12. KEK-u | 8 | 1 |

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli - KEK-u, Trepça '89 - Flamurtari, Drenica - Drita, Ballkani - Ferizaj, Gjilani - Liria, Prishtina - Llapi.

### LIGA E PARË

| | |
|---|---|
| Besa - Vushtrria | 2-0 |
| Vëllaznimi - Fushë Kosova | 3-1 |
| Trepça - 2 Korriku | 3-0 |
| Istogu - Bashkimi (K) | 7-1 |
| Vitia - Drenasi | 1-0 |
| Arbëria - Onix | 2-1 |
| Kika - Ramiz Sadiku | 0-1 |
| Vllaznia (P) - Dukagjini | 0-2 |

Tabela

| | | |
|---|---|---|
| 1. Dukagjini | 7 | 17 pikë |
| 2. Vëllaznimi | 7 | 15 |
| 3. Besa | 7 | 14 |
| 4. Vushtrria | 7 | 13 |
| 5. Onix | 7 | 12 |
| 6. Arbëria | 7 | 12 |
| 7. Vitia | 7 | 11 |
| 8. Istogu | 7 | 9 |
| 9. Trepça | 7 | 9 |
| 10. Ramiz Sadiku | 7 | 9 |
| 11. Drenasi | 7 | 8 |
| 12. Kika | 7 | 8 |
| 13. Fushë-Kosova | 7 | 7 |
| 14. Bashkimi (K) | 7 | 6 |
| 15. 2 Korriku | 7 | 6 |
| 16. Vllaznia | 7 | 1 |

## SHKURT

### Më 28 tetor kursi për Licencën A

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se kursi i fundit i licencimit UEFA A do të mbahet më 28 tetor në Federatën Shqiptare të Futbollit. Sipas FFK-së, kriteri bazë për të aplikuar është posedimi i licencës B, i lëshuar po nga FShF-ja. Po ashtu, kursi për përgatitje fizike për trajner fillon më 8 tetor 2018, ndërsa data e fundit për lajmim në Federatën e Futbollit të Kosovës është 4 tetori.

### Bashkimi transferon Jordan Marshallin

KB Bashkimi ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar, Jordan Marshall, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lojtari lartpërmendur mund të regjistrohet në FBK dhe të paraqitet për KB Bashkimi pas plotësimit të kritereve në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në federatë.

### Hasani i jep mbështetje O'Connellit për zhvillimin e ragbit

Presidenti i Komitetit Olimpik i Kosovës (KOK), Besim Hasani, e falënderoi kryetarin e Federatës së Ragbit të Kosovës, Ruairi O'Connell, njëherësh ambasador i Britanisë së Madhe në Kosovë, për kontributin e jashtëzakonshëm në themelimin dhe drejtimin e Federatës së Ragbit. Me këtë rast Hasani ofroi mbështetjen dhe gatishmërinë për ta ndihmuar kryetarin e FRK-së, Ruairi O'Connell, në mënyrë që sporti i ragbit të ecë me hapa të shpejtë drejt zhvillimit. Nga ana e tij, ambasadori O'Connell është shumë mirënjohës për ndihmën që mori nga Komiteti Olimpik i Kosovës për themelimin e federatës së re. "Në Kosovë momentalisht veprojnë gjashtë klube të regjistruara, por në bashkëbisedimin mes presidentit Hasani dhe kryetarit O'Connel u tha se duhet ta vazhdojnë nxitjen, promovimin dhe zhvillimin e klubeve dhe të këtij sporti. Palët u pajtuan që deri në fund të vitit, KOK-u ta organizojë kursin bazik për administratorë të sportit për Federatën e Ragbit të Kosovës", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

### Ronaldo mohon akuzat për përdhunim

Cristiano Ronaldo ka mohuar vërtetësinë e akuzave për përdhunim. Ylli i Juventusit insiston se ka një ndërgjegje të pastër dhe do të presë me qetësi rezultatin e investigimit. "I mohoj në mënyrë kategorike akuzat ndaj meje. Përdhunimi është një krim i neveritshëm. Megjithëse dua që këto akuza të largohen sa më shpejt, refuzoj të them gjëra që do t'i shërbenin spektaklit mediatik të krijuar nga njerëz që kanë në mendje vetëm ta promovojnë veten e tyre në kurrizin tim. Ndërgjegjia ime e pastër do të më lejojë të pres me qetësi rezultatin e investigimit të kësaj çështjeje", ka thënë Ronaldo, i cili është akuzuar nga një grua amerikane për përdhunim në një hotel të Las Vegasit më 2009.

## Silva: Sevilla ma dha besimin, por jam lojtar i Milanit

SEVILLE, 3 TETOR - Njeriu në skuadrën e Sevillas pa dyshim se është sulmuesi Andre Silva. Portugezi është marrë në huazim me të drejtë blerje nga Milani dhe duket se është ambientuar në mënyrë të përkryer në Spanjë. Janë shtatë, golat e shënuar në kampionat nga talenti portugez, i cili ka folur për "calciomercato", ku dhe ka diskutuar për momentin e tij dhe për Milanin. "Të them të drejtën nuk e prisja një fillim të tillë. Ndihem shumë mirë, si në fushë ashtu dhe jashtë saj, dhe për këtë duhet t'i falënderojë shokët e ekipit dhe trajnerin. Unë luaj për Sevillan, por jam një lojtar i Milanit, të paktën deri në qershor. Nuk kam ndonjë përgjigje për ta shpjeguar formën time në sezonin e parë në Itali, por di që këtë sezon jam në formë dhe po ndihem shumë mirë. Gjëja kryesore është besimi. Në qoftë se ke besim, ti mund të bësh gjithçka. E dija që Sevilla është një klub i madh dhe kishte shumë besim tek unë", ka pohuar Silva.




# Fitojnë Tirana dhe Luftëtari, Flamurtari bie në Laç




Tirana fiton 2-3 me Kastriotin në stadiumin "Redi Maloku" në Fushë-Krujë, duke i ofruar qetësi trajnerit Ze Maria në punën e tij. Greca dhe Blazhveski me një dygolësh mjaftuan për të mundur në transfertë ekipin më të dobët në Superiore, që me gjithë përpjekjet e shumta, nuk arriti ta shmangte disfatën e radhës, edhe pse arriti të shënonte dy gola. Në fakt, skuadra e Plorit fillimisht dha përshtypjen që mund ta fundoste Tiranën, kur në minutën 30 Bardhi zhbllokoi takimin me portën e boshatisur. Gjithsesi, Tirana reagoi shumë shpejt me Bedri Grecën, që vetëm katër minuta më pas ktheu ekuilibrat në rezultat. Tirana e shfrytëzoi në maksimum momentin pozitiv, duke realizuar edhe të dytin me Blazhveskin, që do të rezultonte vendimtar në këtë sukses të bardheblluve. Sulmuesi maqedonas shënoi të dytin personal në minutën e 73-të, kur pas një kundërsulmi shmangu edhe portierin Kuka, për ta dërguar topin në rrjetë. Në minutën e 81-të Marku shkurtoi diferencën në 2-3, edhe pse ky finalizim ishte për moviolë, me topin që e kishte kaluar lehtësisht vijën fatale, para se të largohej nga mbrojtje. Përfundimisht 2-3 në "Redi Maloku", rezultat që i jep frymëmarrje Tiranës, ndërsa fundos Kastriotin në klasifikimin e përgjithshëm. Flamurtari e ka të vështirë të kthehet ajo skuadër pretendente që u shfaq në ndeshjet e para të Superiores. Kuqezinjtë pësuan humbjen e tretë në katër ndeshjet e fundit, këtë herë 1-0 në fushën e Laçit. Goli që mori vlerë tripikëshe për kurbinasit u shënua nga Gjoni në minutën e 59. Reagon pozitivisht edhe Luftëtari, që mori maksimumin e pikëve ndaj një rivaleje si Kamza në Gjirokastër. Edhe në këtë takim u shënua vetëm një gol dhe mban firmën e Rapos në të 66-n. Skuadra e Mezanit me këtë sukses mbetet në vendin e parafundit, por në kuotë të barabartë pikësh me Kamzën.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Laçi-Flamurtari Vlorë | 1-0 |
| Kastrioti-Tirana | 2-3 |
| Luftëtari-Kamza | 1-0 |

# Ndeshje të lehta për favoritët në Evropa Ligë

MILANO, 3 TETOR - AC Milan, pas fitores së vështirë ndaj Dudelange (0-1), do të ketë testin e dytë në Evropa Ligë ndaj Olympiacosit. Milani ka arritur një fitore bindëse në fundjavën që shkoi ndaj Sassuolos (1-4) dhe tash do të jetë i motivuar edhe për këtë ndeshje, kurse grekët e Olympiacosit në ndeshjen e parë u ndanë baras me Betisin, pa i dhënë gola njëri-tjetrit. Arsenali, një tjetër favorit në këtë garë, sonte luan si mysafir i skuadrës së Ansi Agollit, Qarabagut. Fitorja mbetet alternativa e vetme për klubin anglez që në ndeshjen e parë arriti fitore kundër Vorsklas. Skuadra tjetër angleze, Chelsea, që po kalon nëpër një formë të mirë në këtë kampionat, do të luajë ndaj Vidit, kurse trajneri Maurizo Sarri do ta ketë rastin të bëjë ndryshime në formacion.

| | |
|---|---|
| **GRUPI A** | **GRUPI G** |
| 18:55 Bayer Leverkusen - AEK Larnaca | 21:00 Rangers - Rapid Wien |
